



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Nr. 58/2021

Datë: 11 .05.2021

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 7 / 01 Mars 2019, Prishtinë), si dhe Rregulloren e MF-it me Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Ibër Alaj, nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e projekt-propozimeve të arritura sipas konkursit të shpallur nga Departamenti i Kulturës në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2021 në sektorin e Filmit.
2. Anëtar të komisionit caktohen:
 - 2.1. Kimete Berisha - kryesues,
 - 2.2. Fëllanza ZhuriDalladaku - anëtare,
 - 2.3. Trime Manaj - anëtare,
 - 2.4. Nafije Misini- (përfaqësues në cilësinë e ekspertës së jashtëm) dhe
 - 2.5. Herolind Ademi - (përfaqësues nga OJQ).
3. Komisioni do të bëjë vlerësimin e projekt-propozimeve në bazë të kapitullit V të rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
4. Komisioni ka mandat të shqyrtojë projekt-propozimet e pranuar në konkursin e cekur në pikën 1 të dispozitivit të vendimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Anëtareve të komisionit
- Departamentit të Kulturës;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së;

Ibër Alaj
zv. Sekretar i Përgjithshëm